



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Maliq, më 28.10.2021

PROJEKT-VENDIM - NR. 6
PËR

**"DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË "KLUBIT TË
FUTBOLLIT MALIQ SH.A" NË MASEN 100%"**

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 " Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak", gërma (dh), neni 64, "Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë", gërma (a), Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 113, pika 2; Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1, nenpika 1.1, shkronja "b", nenpika 1.2, shkronja "a"; Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar; VKM me nr. 1719, datë. 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", i ndryshuar; pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Maliq

PROPOZOJ:

1. Dhënie e pëlqimit për fillimin e procedurave të shpalljes për shitje 100% të aksioneve që Bashkia Maliq zoteron si aksionere e vetme në Shoqërinë "Klubi i Futbollit Maliq sh.a".
2. Forma e shitjes së aksioneve që zoterohehen nga Bashkia Maliq në Shoqërinë Klubi i Futbollit Maliq sh.a, të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese: Procedurë e Hapur Standard e Ankandit, sipas dokumenteve standarde tip të ankandit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Shoqëria Aksinere.

Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Datë 28.10.2021

RELACION

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË SHITJES SË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT "KLUBI I FUTBOLLIT MALIQ sh.a."

Në lidhje me fillimin e procedurave të xjerrjes në ankand publik të aksioneve të "Klubi i Futbollit Maliq sh.a.", po ju informoj me procedurën ligjore si më poshtë:

- Procedura ligjore do të zhvillohet me ankand publik. Baza ligjore; ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik" i ndryshuar; ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, ligjin nr. 79/2017 "Për sportin" i ndryshuar; VKM nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" të ndryshuar;

Sistemi i drejtimit të shoqërisë është organizuar me dy nivele: Këshilli Mbikqyres dhe Administratori. Te drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga ligji për Asamblene e Përgjithshme të shoqërisë, i ka Bashkia, e perfaqësuar nga Kryetari I Bashkisë.

Hapat e procedurës që po ndiqet janë:

- o Vlerësimi i vlerës së aksioneve të sh.a.-së nga eksperte të licencuar ku do konkludohet me një vlerë të shoqërisë e cila do përbëjë edhe vlerën minimale të shitjes në ankandin publik. **Për këtë qëllim është kontaktuar me kontabilistin Anila Çunoti e cila është i kontraktuar nga Bashkia Maliq për bilancet e shoqërisë për vitin 2020.** Ky bilanc nuk është përfunduar ende. Ky auditues do të bëjë edhe vlerësimin e aksioneve për shitje. Propozimi për këtë kontabilist bëhet për shkak se ai është emëruar si ekspert kontabël për Klubin e futbollit Maliq.
- o Aksionet e vlerësuara me akt ekspertimi, do të propozohen në Këshill Bashkiak në mbledhjen e radhës për dhënie të pëlqimit për shitjen e aksioneve nëpërmjet ankandit publik. **Mbledhja e Këshillit mund të njoftohet dhe zhvillohet brenda 7 ditëve. (në fakt ligji parashikon detyrim për konsultim publik për këtë qëllim meqë ka të bëjë me tjetërsim të pronës (aksioneve) të Bashkisë.**
- o Pas vendimarrjes së Këshillit, lirohet urdhëri i titullarit për shpalljen e ankandit publik dhe ngritjen e komisionit. **Në komision duhet të marrin pjesë edhe të paktën 2 specialitë nga Federata Shqiptare e Futbollit të cilët duhet të delegohen më shkrim nga kjo e fundit. Komisioni harton kriterete dhe kushtet e kontratës (të cilat në këtë rast duhet të jenë minimalet e lejuara nga ligji) dhe kushtet për përdorimin e ambjentëve dhe emrit të cilat do sygjerohen nga Këshilli dhe do përpunohen nga specialitetët. **Kjo****

procedurë mund të zgjasë rreth 5-10 ditë në varësi të disponimit të anëtarëve përfaqësues nga federata Shqiptare.

- Realizimi i ankandit, ku përfshihet shpallja (për 25-30 ditë, në varësi të ditëve pushim që mund të jenë në fund të afatit) dhe vlerësimi nga komisioni ku përsëri janë të nevojshme rreth 5-10 ditë në varësi të disponimit të anëtarëve përfaqësues nga federata Shqiptare.
 - Lidhja e kontratës realizohet menjëherë pas konfirmimit të procedurës¹.
- **Për tu konsideruar:**
- Në vlerësimin e vlerës së shitjes do të përfshihet vetëm e drejta e përdorimit të ambjenteve (stadiumi dhe anekset). Nëse kjo e drejtë do lejohet nga Bashkia dhe do të parashikohen modalitetet e mirëmbajtjes periodike dhe investimit që duhet të realizojë blerësi në ambjente.
 - Vlerësimi do bëhet edhe mbi debitë (borxhet) që ka shoqëria, duke ulur vlerën e shitjes nëse këto borxhe do lihen në përgjegjësi të blerësit.
 - Vlerësimi i vlerës do bëhet edhe mbi të drejtat që ka Bashkia sot mbi kontratat e futbollistëve, afatet dhe federimet e tyre.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

